



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më . \_\_\_\_ .04.2023

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Qëndresa Qytetare  
Adresa: Rruga “Ali Pashë Gucia” Pallati 42, kati 0 **Tiranë**  
E-mail : qendresaqytetare@gmail.com

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 703 prot datë 11.04.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, kërkohet a ka Autoriteti informacion ose dokumentacion nëse kanë qenë ish bashkëpunëtorë të ish Sigurimit Rektorët dhe Anëtarët e Akademisë së Shkencave të listuar emrat e 43 shtetasve, ju informojmë se baza ligjore e kërkesës së paraqitur, është e paplotë.

Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkues që mund të kenë qasje në informacion, *(kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, studiues, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit të ish-Sigurimit të Shtetit, i afërm e familjar i tyre si dhe institucione për verifikim zyrtarësh, kandidat për deputet/kryetar bashkie, apo çdo person)*, objektin, qëllimin dhe përdorimin e informacionit, të drejtat e kërkuesve, mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve, kriteret e përdorimit të informacionit si edhe dispozitat proceduriale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015.

Gjithashtu lidhur me procedurën për shqyrtimin e dokumenteve, vënien në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve, nevojitet të plotësohet nga cdo kërkues një nga tipologjitë e formularëve përkatës të miratuara nga Autoriteti me qëllim adresimin e kërkesës tuaj, në dispozitën e përcaktuar nga ligji e më pas vijimin e trajtimit të kërkesës.

Bashkëlidhur do të gjeni formularin për çdo individ dhe formularin dhe Udhëzuesin për studiues/media të miratuara nga Autoriteti.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Suela Prençi**